



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 107, datë 16.12.2024

PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË 4,133,471 LEKË, PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME SI PASOJË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESAT E TYRE

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr.3806/1 prot, datë 29.03.2024 me kodin e produktit: “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”- kodi i produktit 91707AB dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4,133,471 (katërmilion e njëqind e tridhjetë e tremijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre, sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	Emër Mbiemër	Njësia Admin.	Data e kërkesës	Shkaku i fatkeqesisë sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012 dhe Ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"	Preventivi për orendit/sendet llogaritur nga KQD	Preventivi për materiale ndërtimore llogaritur nga KQD, në masën 50 % sipas VKM-së 329, datë 16.5.2012	Vlera e dëmit në total për përfituesit
1	Emilian Selimi	2	04.01.24	Zjarri	256,000	11,834	267,834
2	Xhemile Begu	Rrashbull	05.01.24	Zjarri	165,000	Nuk ka	165,000
3	Sabah Hadroj	6	15.12.23	Zjarri	110,000	136,834	246,834
4	Fatime Hekuri	5	05.02.24	Zjarri	784,000	794,857	1,578,857
5	Albana Meta	5	13.05.24	Zjarri	717,000	73,115	790,115
6	Enver Thika	5	16.04.24	Zjarri	953,000	131,831	1,084,831
Totali i vlerës për disbursim							4,133,471

- Ky fond do të merret nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit, për mbrojtjen civile, i akorduar me kodin e produktit: 91707AB, "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.


KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 17.12.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 758 / prot.
3

Durrës, më 24.12 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.107 datë 16.12.2024 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 4,133,471, për familjet që kanë pësuar dëme si pasojë e rënies së zjarrit në banesat e tyre”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

